

**AKT - THEMELIMI  
PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE  
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR” COUNTRY ESTATE ”Sh.p.k**

Sot me date 10/04 2023,ne shtetasit;

**1-Z.KEVIN XUKTHI I biri I Renatos** ,lindur më 17.06.2002,ne Tirane dhe banues ne rrugen Sami Frasheri Tirane,me shtetesi dhe kombesi Shqiptare,madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; mbajtes i ID nr .K20617040F

DHE

**ZNJ. BESMIRA BASHOLLI** ,e bija e Selmanit ,e datelindjes 01.06.1990 ,lindur ne Pogradec e banues ne Nj. Administrative nr 7 Tirane ,madhore,me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar nepermjet pasaportes ID me nr. J05601125K

Me iniciativen tone te lire si dhe duke u bazuar ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise , Kodin Civil ne fuqi , ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare” , ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 « Per Qendren Kombetare te regjistrimit « , ate Doganor , Fiskal , Tatimor vendosem te krijojme Shoqerine shqiptare me pergjegjesi te kufizuar per sa me poshte vijon :

Neni 1

**EMERTIMI I SHOQERISE**

Te formohet shoqeria tregtare shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “**COUNTRY ESTATE ”Sh.p.k**

Neni 2

**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE.**

Shoqeria“**COUNTRY ESTATE ”Sh.p.k**,krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pakufizuar, mbi dhjete vjete pune te njepasnjeshme. Ky afat mund te shkurtohet per rastet kur shoqeria do te shperbehet sipas percaktimeve qe do te pasqyrohen ne Statut.

Neni 3

**QENDRA E SHOQERISE**

Shoqeria e ka selin ne Tirane **Kashar Rruga Dhaskal Todri ,Godina nr.33, Zona kadastrale 2105 , pasuria nr 184/146.Tirane . Shqiperi.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege,te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendimin e asamblese se ortakeve.

Neni 4

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Shoqëria tregëtare private “**COUNTRY ESTATE”Sh.p.k**, do te ushtroje te gjitha aktivitetet te lejuara nga ligji, duke perfshire :

1. Aktivitete te agroturizmit dhe zhvillimit rural, restorante dhe te ngjashme, hoteleri dhe te ngjashme. Merr, trajton, magazinon, ruan, perpunon dhe prodhon, tregton, blen, shet dhe merret me cdo menyre ose mjet tjeter te produkteve bujqesore dhe blektorale. Te ushtroje aktivitet ne fushen e prodhimit dhe perpunimit, ambalazhimit, marketimit dhe tregtimit te produkteve blegtorale, bujqesore, shtazore dhe e te gjitha derivateve te tyre. Te kryej cdo veprim tjeter qe lidhet me prodhimin, perpunimin dhe tregtimin ne fushen e produkteve

bujqesore, shtazore dhe blegtorale ne teresi, ne perputhje te plote me legjislacionin Shqiptare ne fuqi.

2. Prodhim, Grumbullim, tregtim te bimeve dhe frutave natyrale, mjekesore dhe perpunimin e tyre ne barna popullore etj.

Objekti i veprimtarise te shoqerise mund te ndryshohet, perditesohet, plotesohet ne cdo moment me vendim te Asamblese se Ortakeve.

## **Neni 5**

### **REGJIMI JURIDIK**

Ne te gjithe territorin e saj ne Republiken e Shqiperise ,Shoqeria do te udhëhiqet nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise dhe te ortakeve te saj percaktohen me hollesisht ne Statutin qe i bashkengjitet ketij Akti.

Shoqeria gezon mbrojtje dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Per evidentimin e veprimtarise se Shoqerise do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi,dhe kerkesat e pergjitheshme te kontabilitetit ,sic sqarohet me hollesisht ne dispozitat perkatese te Statutit te Shoqerise.

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi .

## **Neni 6**

### **ORTAKET THEMELUES**

**Themelues te shoqërisë“COUNTRY ESTATE sh.p.k ,jane Z. Kevin Xukthi dhe Znj.**

**Besmira Basholli.**

## **Neni 7**

### ***Kapitali themeltar***

7.1.Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1.Ortaku themelues Z.Kevin Xukthi ,Zoterues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 60.000leke(gjashtedhjetë mijë ) Lekë ,që përben 60% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku themelues Z.Besmira Basholli j,Zoterues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 40,000 leke(dyzetë mijë Lekë )që përben 40% të kapitalit themeltar të shoqërisë..

7/2 Kapitali i shoqerise do te rritet krahas ecurise se saj ekonomike ,financiare si dhe te vendimeve qe do te marrim ne ortakët per ta rritur ate ne te ardhmen

Kapitali do te jete prone e dy ortakeve i ndare sipas perqindjes qe ata kane rene dakorte sa me siper.

Kapitali do te shlyhet kur kjo Shoqeri te regjistrohet ne QKR .

7/3 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie , ne rast ndarje pasurore mes bashkeshortëve dhe nepermjet paraardhesve e pasardhesve sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

7/4 Fitimi i shoqërisë i përket tërësisht ortakëve të shoqërisë .

Ky fitim do të disponohet lirisht prej tyre , ne baze te raportit te kontributit te tyre ne kapitalin themeltar, pasi të jenë shlyer më parë detyrimet tatuese fiskale dhe ato ndaj të tretëve dhe

te jene hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1\10 te kapitalit te shoqerise .

Neni 8

### **DREJTIMI I SHOQERISE**

Organ drejtues dhe vendimor në këtë shoqëri është Asambleja e Ortakeve .

8/1 Kjo Asamble merr vendime te zakonshme ose te jashtezakonshme sipas disponimeve te statutit te shoqerise .

8/2 **Shoqeria do te administrohet nga Administratori I jashtem Renato Agustin Xukthi** ,i datelindjes 22.04.1966 , lindur ne Fier e banues ne Tirane ,madhor,me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit ID.nr. G60422010D,i cili do te kryej kete detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Administratori përfaqësonë juridikisht shoqerine në të gjitha organet apo organizmat e aparatit shtetëror dhe në marrëdhëniet me të tretët, kur veprimet kanë të bëjnë me disponimin e interesave materiale të shoqërisë.

8/3 Per cdo ceshtje profesionale ,si juridike ,ekonomike ,teknike etj ,shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkoheshme duke punesuar specialist sipas legjislacionit ne fuqi .

Neni 9

### **SIGURIMI I PASURISE SE SHOQERISE**

9/1 Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi .

9/2 Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga Administratori .

Neni 10

### **MBYLLJA EKONOMIKE VJETORE E SHOQERISE**

Si rregull, veprimet ekonomike të shoqërisë do të mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur e kërkon organi kompetent ligjor.

Neni 11

### **LIKUJDIMI I SHOQERISE**

Shoqëria do të shpërbëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në statutin e saj.

Neni 12

### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

12/1 Ky akt per themelimin e Shoqerise ka si pjese te saj edhe Statutin e Shoqerise i cili bashkengjitet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

12/2 Ne rastet e likujdimit perfundimtar te Shoqerise ,sipas legjislacionit ne fuqi ,pushon se vepruar edhe ky Akt - Themelimi .

12/3 Çdo ndryshim apo shtese qe mund ti behet ketij Akti per Themelimin e saj duhet te behet me shkrim ,te nenshkruhet nga ortaket e saj dhe te depozitohet si ne dokumentat e shoqerise qe mbahen ne Qendren e saj,ashtu edhe ne QKR perkatese .

12/4 Te gjitha mosmarreshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirkuptim , do te paraqiten per zgjidhje ne Gjykatën kompetente Shqiptare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi . Ortaket nenshkruan aktin ne presence te noterit.

Ky Akt Themelimi i shoqerise u printua ne kater kopje te barabarta dhe u nenshkrua nga ne ortaket e saj me vullnet te lire dhe te plote,

**Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt themelimi do të aplikohet Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.**

ORTAKET E SHOQERISE" "COUNTRY ESTATE"Sh.p.k

1-Kevin Xukthi

Kevin Xukthi

A handwritten signature in blue ink, consisting of the letters 'K' and 'X' intertwined.

Besmira Basholli

Besmira Basholli

A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized representation of the name 'Basmira'.